



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0005630-19/26 dt. 10.02.2026

Mitrovicë

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, pika d, dhe nenit 40, pika d, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/2008); nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe nenit 46, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 10.02.2026, pasi shqyrtoi Raportin e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025, sjell këtë:

VENDIM

Për miratimin e Raportit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025

1. MIRATOHET Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025.
3. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë



Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
1 x 1 MAPL-së
1 x 1 Arkivit
Kopje: Kryetarit të Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0005630-19/26, dt. 10.02.2026

Mitrovicë

RAPORT I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS JANAR - DHJETOR 2025

Kuvendi i Komunës si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisjes lokale, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë, duke përdorur me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore si dhe teknologjike të komunës. Veprimtaria e Kuvendi i komunës së Mitrovicës së Jugut mbështetet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga Kushtetuta e Kosovës, parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet e tjera të cilat prekin nivelin lokal, Statutin e komunës si dhe rregulloret e miratuara nga vet Kuvendi i Komunës, si më poshtë:

- Ligjin për vetëqeverisjen lokale
- Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës
- Ligjin për bashkëpunim ndërkomunal
- Ligjin për kufijtë administrativ të komunave
- Ligjin për financat e pushtetit lokal
- Ligjin për zgjedhjet lokale në republikën e Kosovës
- Ligjin për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë etj.

Raporti vjetor i punës së Kuvendit të Komunës i vitit 2025 synon të japë një panoramë analitike dhe informacionin e nevojshëm mbi aktivitetin Kuvendit dhe punën e Sekretarisë së Kuvendit në përmbushje të detyrave të këtij institucioni të rëndësishëm. Përmes këtij Raporti mundohemi t'u krijojmë informim të duhur qytetarëve lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre lokal. Raporti shërben edhe si një mjet tjetër që do të rrisë transparencën në lidhje me aktivitetin e pushtetit lokal për periudhën e raportimit.

Në zbatim të përgjegjësisë së vetë si organ i komunës, Kuvendi i Komunës ka marrë vendime të rëndësishme për periudhën janar - dhjetor 2025, si:

Kuvendi i Komunës ka miratuar Buxhetin për vitin 2026 në shumë prej 32,418, 756.00 €, dhe parashikimet për vitet 2027-2028.

Përmbledhje

Raporti i hartuar përmbledh të dhëna për funksionimin e Kuvendit, funksionimin e komiteteve obligative dhe funksionale, dhe komiteteve dhe trupave tjerë të Kuvendit, pasqyrën e realizimit të objektivave sipas planit, si dhe vendimmarrjen. Prezantimi i aktiviteteve të Kuvendit të Komunës ka rëndësi të shumëfishtë, ngase me ligj Kuvendi i Komunës njihet organi më i lartë në strukturën organizative të Komunës dhe i ushtrojnë kompetencat vetanake dhe të deleguara në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Pasqyrimi i punës së Kuvendit përfshinë në mënyrë indirekte edhe shpalosje e punës së ekzekutivit, respektivisht Kryetarit të Komunës, duke ditur se ky i fundit raporton në baza të rregullta ose kur kërkohet në Kuvendin e Komunës. Andaj, ky raport ka për qëllim informimin e qytetarëve, institucioneve relevante qeveritare dhe joqeveritare, por edhe vetë komunën, lidhur me nivelin e respektimit të ligjshmërisë nga vet komuna.

Përveç funksionit legjislativ, Kuvendi gjatë periudhës raportuese ka ushtruar edhe funksionin e kontrollit dhe në përmbushje të këtij funksioni, u zhvilluan dhe u shqyrtuan raportime të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive komunale, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës janë organizuar dëgjime buxhetore dhe dy takime me publikun dhe takime tjera publike për Draft Rregullore komunale dhe plane. Në përmbushje të objektivave Sekretaria e Kuvendit gjatë vitit 2025 kanë punuar për mbarëvajtjen e punës në Kuvendin e Komunës. Stafi i Sekretarisë ka mbështetur dhe ndihmuar në vazhdimësi këshilltarët për plotësimin e detyrimeve të përcaktuar nga Ligji për Statusin e anëtarit të Kuvendit dhe Rregulloren e Kuvendit. Gjithashtu ka punuar në drejtim të plotësimit dhe përmirësimeve në strukturën administrative, ka punuar për koordinimin e punës në drejtim të hartimit të akteve të nxjerra nga Kuvendi dhe të hartimit të një buxheti sa më real dhe të zbatueshëm.

Gjatë kësaj periudhe, puna e Zyrës së Teknologjisë Informative (IT) ka qenë e angazhuar në vazhdimësi në mirëmbajtjen e sistemeve informative, si: rrjeti, sistemi audio, votimit elektronik, sigurimi i pajisjeve gjatë zhvillimit të aktiviteteve brenda ambienteve të Kuvendit, kompjuterët, printerët, skanerët, fax-ët, faqja e internetit, serveri, e-mail-i, akses kontrolli. Zyra për informim ka pasqyruar në faqen e internetit në kohë reale informacionin për aktivitetin tërësor të Kuvendit të Komunës. Janë mundësuar mënyra të komunikimit dhe të kontakteve efikase me mediat, duke siguruar nëpërmjet tyre një komunikim më të shpejtë dhe me një impakt të menjëhershëm.

Sa i përket menaxhimit të buxhetit të Zyrës së Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit dhe Sekretaria e Kuvendit, në rolin e koordinatorit të këtij procesi ka përpiluar dokumentin e Programit buxhetor të Zyrës së Kuvendit për vitin 2025. Buxheti i Kuvendit është i ndarë dhe përfshinë të gjitha shërbimet që i nevojiten organit si një i tërë.

Kuvendi i komunës (Zyra e Kuvendit) ka pasur në buxhetin e zyrës të miratuar për vitin 2025 në shumë prej 247,700.00 €, sipas kategorive buxhetore si në vijim:

Paga dhe mëditje 235,700.00€

Mallra dhe shërbime 12,000.00 €

Sekretaria e Kuvendit do të vijojnë të përmbushin me kompetencë dhe cilësi, në mënyrë të paanshme dhe të pavarur, detyrat e parashikuara në Rregulloren e punës së Kuvendit.

Bazuar në nenin 40, paragrafi 2, pika d. të Ligjit Për vetëqeverisje lokale, nenin 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës, ky raport i paraqitet për miratim Kuvendit të Komunës. Më poshtë po bëjmë një përmbledhje të këtij raporti duke u ndalur në disa nga aspektet më të rëndësishme të punës së Kuvendit.

KUVENDI I KOMUNËS

Kuvendi i Komunës në periudhën janar - dhjetor 2025 ka mbajtur gjithsej 6 mbledhje, prej tyre:

- 1) 5 - mbledhje të rregullta,
- 2) 0 - mbledhje të jashtëzakonshme, dhe
- 3) 0 - mbledhje urgjente.
- 4) 1 - mbledhje solemne.

Tabela Nr. 1 - E mbledhjeve të Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2025.

MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS														
Nr.	Muaji	Mbledhjet				Nr. i p. i këvë	P. V. e r. b. a. l	Rr. e g. u. l. l. o. r. e	P. v. e. n. d. i. m	P. l. a. n. e	R. a. p. o. r. t	T. j. e. r. a	V. e. n. d. i. m. e	Pjesëmarrja në mbledhje
		Nr. i mbledhjeve	Rregullta dhe inauguruese	jashtëzakonshme	ur gjente									
1.	Janar													
2.	Shkurt	1	27.02.2025			6	1		2		2	1	5	30/35
3.	Mars	1			05.03.2025									21/35
4.	Prill		28.04.2025			14	1		9	1	2	1	6	33/35
5.	Maj													
6.	Qershor	1	30.06.2025			9	1		5		2	1	7	30/35
7.	Korrik	1												
8.	Gusht													
9.	Shtator	1	11.09.2025			6	1		3		1	1	9	32/35
10.	Tetor													
11.	Nëntor													
12.	Dhjetor	1	12.12.2025 inauguruese			betimi								30/31
	Gjithsej	6	5	0	0	1	35	4	19		7	4	27	

Kuvendi si organi më i lartë i Komunës në të cilin shqyrtohen dhe miratohen aktet ligjore që janë në kompetencë të Komunës është institucioni ku zhvillohet dialogu politik konstruktiv dhe i qëndrueshëm ndërmjet të gjitha forcave politike për realizimin dhe ushtrimin të funksionit legjislativ dhe funksionit zgjedhës, kjo konsiston në treguesit e mëposhtëm:

Për periudhën raportuese Kuvendi i Komunës në mbledhjet e mbajtura ka shqyrtuar gjithsej 35 pika të rendit të punës, me ç'rast ka miratuar, 0 Rregullore, 0 Statut, 27 Vendime, 1 plane dhe ka shqyrtuar 7 raporte.

Të gjitha mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun duke përfshirë edhe mbledhjet e komiteteve.

RREGULLORET DHE VENDIMET E KUVENDIT TË KOMUNËS TË MIRATUARA GJATË VITIT 2025

Tabela Nr.2:Vendimet e dt.27.02.2025 (shkurt 2025)

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kundër	Abst.	
1.	Vendim Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 26.12.2024	27	0	0	02-060/01-0010215-1/25
2.	Vendim Për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës për vitin 2025	29	0	0	02-060/01-0010215-2/25
3.	Vendim Për formimin e Grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025	29	0	0	02-060/01-0010215-3/25
4.	Vendim Për miratimin e Raportit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024	28	0	0	02-060/01-0010215-4/25
5.	Vendim Për miratimin e Raportit financiar për periudhën janar-dhjetor 2024	20	0	0	02-060/01-0010215-5/25

Tabela Nr.3:Vendimet e dt. 28.04.2025 (prill 2025)

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kundër	Abst.	
1.	Vendim Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së 38- të rregullt të Kuvendit të Komunës dt. 27.02.2025	32	0	0	02-060/01-0021659-1/25
2.	Vendim Për Miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut (HZK) 2024-2032	17	0	0	02-060/01-0021659-2/25
3.	Vendim Për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale “Diakonie Kosova” pa procedura konkurrimi	22	0	0	02-060/01-0021659-3/25
4.	Vendim Për miratimin e Kërkesës së Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për ndarjen e mjeteve buxhetore	22	1	0	02-060/01-0021659-4/25
5.	Vendim Për miratimin e Planit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025	16	0	0	02-060/01-0021659-6/25
6.	Vendim Për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 dhe vitet rraprake në buxhetin e vitit 2025	22	1	0	02-060/01-0021659-7/25

Tabela Nr.4:Vendimet e dt. 30.06.2025 (qershor 2025)

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kundër	Abst.	
1.	Vendim Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 28.04.2025	20	0	0	02-060/01-0035824-1/25
2.	Vendim Për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028	21	0	0	02-060/01-0035824-2/25
3.	Vendim Për Ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 02-060/01-0005769/22-4 dt 31.01.2022 Për	21	0	0	02-060/01-0035824-3/25

Raport i punës së Kuvendit të Komunës janar–dhjetor 2025

	formimin e Komisionit të Aksionarëve të KRM “Uniteti				
4.	Vendim Për Ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 02-060/01-0072093/22-2 dt. 08.08.2022 Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-	20	0	0	02-060/01-0035824-4-5/25
5.	Vendim Për Ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 02-060/01-0080100-5/24 dt.26.12.2024 Për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve në Institucionet edukativo arsimore dhe aftësuese	18	0	0	02-060/01-0035824-6/25
6.	Vendim Për miratimin e Raportit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024	19	0	0	02-060/01-0035824-7/25
7.	Vendim Për miratimin e Raportit financiar i Komunës së Mitrovicës së Jugut për periudhën janar-mars 2025	19	0	0	02-060/01-0035824-8/25

Tabela Nr.5: Vendimet e dt. 11.09.2025 (shtator 2025)

Nr .	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kundër	Abst	
1.	Vendim Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 30.06.2025	24	0	1	02-060/01-0054399-1/25
2.	Vendim Për miratimin e Buxhetit të Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028	21	5	0	02-060/01-54399-2/25
3.	Vendim Për plotësim dhe ndryshim të vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-00216592/25, të datës 28.04.2025	18	0	1	02-060/01-0054399-3/25
4.	Vendim Për mbështetje financiare të Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së	21	0	0	02-060/01-0054399-4.1/25
5.	Vendim Për mbështetje financiare të Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së	21	0	0	02-060/01-0054399-4.2/25
6.	Vendim Për mbështetje financiare (subvencionim) të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së	21	0	0	02-060/01-0054399-4.3/25
7.	Vendim Për mbështetje financiare (subvencionim) të OJQ-së “Zëri i Prindërve”- Mitrovicë	21	0	0	02-060/01-0054399-4.4/25
8.	Vendim Për mbështetje financiare (subvencionim) të Shoqatës Down Syndrome Kosova- Mitrovicë	19	0	0	02-060/01-0054399-4.5/25
9.	Vendim Për miratimin e raportit financiar janar-qershor 2025	21	0	0	02-060/01-0054399-5/25

Aktet e miratuara nga Kuvendi që pas vlerësimit të ligjshmërisë nga niveli qendror janë kthyer në rishqyrtim, data e kthimit nga Ministria si dhe data e rishqyrtimit dhe harmonizimit nga Kuvendi gjatë vitit 2025:

Raport i punës së Kuvendit të Komunës janar–dhjetor 2025

Tabela Nr.6: aktet e kthyera në rishqyrtim,

Nr	Emri i aktit	Data e dërgimit në Ministri	Data e kthimit të kërkesës për rishqyrtim nga MPL-ja	Data e rishqyrtimit dhe harmonizimit nga Kuvendi i Komunës
1.	Vendim nr. 02-060/01-0021659-2/25 dt. 28.04.2025 Për Miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut (HZK) 2024-2032	03.05.2025	14.08.2025	Harmonizuar 11.09.2025.

Të gjitha rregulloret dhe vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës janë të publikuara në ueb faqen e komunës në të dy gjuhët.

Planet dhe strategjitë e miratuara nga Kuvendi i Komunës:

Tabela Nr.7: Planet e miratuara

Nr.	Emërtimi i aktit	Datë
1.	Planit i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025	28.04.2025

Mbetet për detyrë implementimi i tyre në praktikë dhe për të arritur sa më mirë këtë duhet bashkëpunimi i të gjithë hallkave (përfaqësues, ekzekutiv, komunitet).

Raportimi i Kryetarit në Kuvendin e Komunës

Në mesin e përgjegjësiave të Kryetarit të Komunës është edhe raportimi para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare si administrues i financave të komunës lidhur me shpenzimet komunale, investimet kapitale, dhe shfrytëzimin e parasë publike. Bazuar në raportimet që ka paraqitur, Kryetari i Komunës e ka përmbushur obligimin për raportim në Kuvendin e Komunës brenda vitit. Forma e raportimit ka qenë me shkrim dhe ajo verbale, të cilat janë prezantuar para anëtarëve të Kuvendit. Praktika të tilla, janë parë si mundësi e mirë e bashkëpunimit dhe llogaridhënies së ekzekutivit ndaj Kuvendit të Komunës. Kryetari i Komunës dhe ekzekutivi gjatë kësaj periudhe Kuvendit të Komunës i ka proceduar këto raporte:

Tabela nr.8 Raportet e miratuara nga Kuvendi i Komunës dhe raportimet tjera

Nr.	Emërtimi i aktit	data	Nr. i protokollit
1.	Raportit i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024	27.02.2025	02-060/01-0010215-4/25
2.	Raportit financiar për periudhën janar-dhjetor 2024	27.02.2025	02-060/01-0010215-5/25
3.	Vendim Për miratimin e Raportit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024	30.06.2025	02-060/01-0035824-7/25
4.	Vendim Për miratimin e Raportit financiar i Komunës së Mitrovicës së Jugut për periudhën janar-mars 2025	30.06.2025	02-060/01-0035824-8/25
5.	Vendim Për miratimin e raportit financiar janar- qershor 2025	11.09.2025	02-060/01-0054399-5/25

Mbledhjet e Kuvendit kanë qenë transparente, ftesat dhe materialet për mbledhjet e Kuvendit janë dërguar në përputhje me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit të Komunës dhe Rregullores së punës së Kuvendit. Përveç kësaj, materialet përcjellëse që kanë qenë në rend të ditës

për diskutim në mbledhjet e Kuvendit iu kanë dërguar edhe MAPL-së si autoritet mbikëqyrës. Sekretaria e Kuvendit në afatet e parapara ligjore të gjitha rregulloret, vendimet dhe aktet tjera të miratuara nga Kuvendi i Komunës ia ka proceduar autoritetit mbikëqyrës, respektivisht Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, dhe në afate ligjore i ka publikuar aktet e miratuara në gjuhë zyrtare, ashtu siç e parasheh Rregullorja (e MAPL) Për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, të gjitha aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës janë publikuar në gjuhët zyrtare në faqen elektronike të Komunës. Kjo mundëson qasjen e publikut në informacionet dhe ngjarjet e komunës, si dhe krijon mundësinë për qasje më të lehtë në dokumentet zyrtare.

Sekretaria e Kuvendit ka zbatuar me korrektësi kërkesat ligjore për njoftimet publike (si në faqen zyrtare të komunës, në media vendore, me email drejtuar OJQ-ve, Drejtorëve të komunës, Zyrën e marrëdhënieve me publikun në komunë) në zbatim të Ligjit Për Vetëqeverisjen lokale.

KOMITETET E PËRHERSHME

Si rregull, mbledhjet e komiteteve mbahen para mbledhjeve të Kuvendit. Duke marrë parasysh përgjegjësitë e dhëna me Ligjin për vetëqeverisje lokale, komitetet shqyrtojnë agjendën e propozuar nga Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit, ofrimi i rekomandimeve, shqyrtimi i propozim akteve dhe çështjeve të tjera të cilat parashihen për t'u trajtuar në mbledhjet e Kuvendit të Komunës. Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë kësaj periudhe ka pasur rol të rëndësishëm në adresimin dhe trajtimin e çështjeve të ndryshme të cilat kanë qenë në interesin e përgjithshëm për Komunën. Komiteti për Politikë dhe Financa i ka trajtuar pikat e rendit të ditës para se të kalojnë në diskutim dhe miratim në Kuvendin e Komunës. Trajtim të veçantë Komiteti për Politikë dhe Financa ju ka kushtuar çështjeve të natyrës financiare, si: shqyrtimit të buxhetit, kornizës afatmesme buxhetore të komunës, si dhe çështjeve të tjera në interes të përgjithshëm si: rregulloret komunale, dhënia e pronave të paluajtshme në shfrytëzim afat shkurtër dhe afatgjatë, etj.

Komiteti për Politikë dhe Financa

Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e:

1. Të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare,
2. Planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimin strategjik,
3. Kornizën vjetore buxhetore dhe afatmesme,
4. Planin vjetor të prokurimit,
5. Rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat,
6. Planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm,
7. Buxhetin vjetor dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal,
8. Për marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvend, si dhe
9. Monitorimin e bashkëpunimit, ndër komunal, me nivelin qendror dhe me jashtë.

Kuvendi mund t'i delegojë edhe përgjegjësi tjera nga fushëveprimi i tij Komitetit për Politikë dhe Financa.

Komiteti për Politikë dhe Financa për periudhën raportuese ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje, prej të cilave 8 mbledhje të rregullta dhe 2 mbledhje të jashtëzakonshme.

Komiteti ka shqyrtuar 27 pika të rendit të punës.

Tabela Nr.9 mbledhjet e KPF-së

Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa

Raport i punës së Kuvendit të Komunës janar–dhjetor 2025

Nr.	Muaji	Nr. mbledhjeve	Të rregullta	Të jashtëza konshime	Data	Nr. pikave	P. verbal	Rregullor e	P. vendim	Plan e	Raport e	Tjera	Pjesëmarrja
1.	Janar	1	1		31.01.2025	4	1		2		1		9/9
2.	Shkurt	1	1		26.02.2025	2	1				1		8/9
3.	Mars	1	1		28.03.2025	4	1				1	1	8/9
4.	Prill	2	1	1	04.04.2025 25.04.2025	1 6			1 2				8/9 8/9
5.	Maj	1	1		30.05.2025	2	1					1	8/9
6.	Qershor	1	1		19.06.2025	2	1		1				8/9
7.	Korrik	1	1		25.07.2025	2	1				1		8/9
8.	Gusht	1		1	25.08.2025	2	1		1				8/9
9.	Shtator	1	1		10.09.2025	2	1		1				8/9
	Gjithsej	10	8	2		27	10		8	1	5	3	

Komiteti për Komunitete

Komiteti për Komunitete përbehet nga anëtarët e Kuvendit dhe përfaqësuesit e komuniteteve dhe është përgjegjës për:

1. Promovimin dhe afirmimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe shqyrton çdo shkelje që bëhet në këtë drejtim dhe bën rekomandime për Kuvendin e Komunës.
2. Shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.
3. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe
4. për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda Komunës.

Komiteti për Komunitete për periudhën raportuese ka mbajtur gjithsej 9 mbledhje të rregullta, ka shqyrtuar 18 pika të rendit të ditës, janë miratuar 9 procesverbale, janë nxjerrë, 9 rekomandime për Kryetarin e Komunës dhe Kuvendin e Komunës (shih tabelën).

Tabela Nr.10 mbledhjet e Komitetit për Komunitete

Mbledhjet e Komitetit për Komunitete											
Nr.	Muaji	Nr. i mbledhjeve	Mbledhje të rregullta	Nr i pikave	P. verbal	p.rregullore	plane	raporte	tjera	rekomandime	Pjesëmarrja në mbledhje
1.	Janar	1	30.01.2025	2	1				1	1	11/11
2.	Shkurt	1	27.02.2025	2	1				1	1	11/11
3.	Mars	1	25.03.2025	2	1			1		1	10/11
4.	Prill	1	30.04.2025	2	1		1			1	11/11
5.	Maj	1	23.05.2025	2	1				1	1	10/11
6.	Qershor	1	19.06.2025	2	1		1			1	11/11
7.	Korrik	1	14.07.2025	2	1				1	1	10/11
8.	Gusht	1	26.08.2025	2	1			1		1	11/11
9.	Shtator	1	10.09.2025	2	1			1		1	11/11
10.	Gjithsej	9		18	9		2	3	4	9	

Komitetet funksionale

Kuvendi i Komunës për kryerjen e përgjegjësiave në sektor të caktuar me vendim ka themeluar Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Komitetin për Barazi Gjinore, Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit, Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komiteti për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Komiteti për Zhvillim Ekonomik. Komitetet funksionale kanë mbajtur mbledhjet si në vijim:

- Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport - 0 mbledhje.
- Komiteti për Barazi Gjinore - 0 mbledhje.
- Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit - 0 mbledhje.
- Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - 0 mbledhje.
- Komiteti për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim - ka mbajtur 1 mbledhje.
- Komiteti për Zhvillim Ekonomik - 0 mbledhje.

Komitetet konsultative

Komitetet konsultative janë trupa ndihmëse të Kuvendit të Komunës, roli i të cilave është që përmes këtyre komiteve të garantohet që organet e komunës të jenë më transparente më efikase dhe ti japin më shumë llogari qytetarëve, si dhe të krijoj mundësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Komitetet konsultative kanë mbajtur mbledhjet si në vijim:

- Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport – 0 mbledhje
- Komiteti Konsultativ për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Aftësi të Kufizuara – 0 mbledhje
- Komiteti Konsultativ për Shërbime Publike, Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit – 0 mbledhje.

Komisionet e Aksionarëve

Komuna si aksionare e ndërmarrjeve publike lokale, të drejtat si aksionar i ushtron përmes Komisioneve Komunale të Aksionarëve. Komisionet Komunale të Aksionarëve veprojnë në emër të Komunës dhe në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për shoqëritë tregtare. Komisionet Komunale të Aksionarëve kanë mbajtur mbledhjet si në vijim:

- Komisioni i aksionarëve të N.P “Qendra Multifunksionale” - ka mbajtur 1 mbledhje.
- Komisioni i aksionarëve të N.P “Stacioni i Autobusëve ” - ka mbajtur 0 mbledhje.
- Komisioni i aksionarëve të N.P “Tregu” - ka mbajtur 0 mbledhje.
- Komisioni i aksionarëve të K.R.M. “Uniteti” - ka mbajtur 6 mbledhje.

Në vitin 2025 Kuvendi ka synuar të forcojë më tej rolin e tij në ushtrim të funksionit kushtetues legjislativ dhe të kontrollit. Me rëndësi të veçantë dhe për t’u vënë në dukje është edhe puna e madhe që u bë nga Kuvendi për miratimin e buxhetit të Komunës për vitin 2025.

Përveç funksionit legjislativ, Kuvendi gjatë vitit 2025 ka ushtruar edhe funksionin e kontrollit politik ndaj ekzekutivit si dhe ka monitoruar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Ligjin për vetëqeverisje lokale, Ligjet dhe aktet tjera nënligjore, Statutin e Komunës, dhe vendimeve të Kuvendit të Komunës, nëpërmjet instrumenteve të kontrollit të parashikuara në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statut dhe me Rregulloren e punës së Kuvendit. Në ushtrim të kontrollit parlamentar u zhvilluan 14 raporte të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive, për të cilat anëtarët e Kuvendit kanë zhvilluar debata dhe kanë marrë përgjigjet për problemet e ngritura.

Objektivat e Kuvendit për vitin 2026

Për vitin 2025 Kuvendi synon të forcojë më tej rolin e tij në ushtrim të funksionit ligjor legjislativ dhe të kontrollit, të forcojë më tej rolin e tij shqyrtues, duke përfshirë shoqërinë civile dhe grupet e interesit në procesin legjislativ, të rrisë dialogun politik mes pozitës dhe opozitës, me qëllim forcimin e funksionimit të tij demokratik, të rrisë më tej transparencën për informimin e publikut me dokumentacionin e nxjerr nga Kuvendi, të forcojë më tej kapacitetet e tij administrative në përgjithësi.

Përfundime

Ftesat, materialet e mbledhjes dhe njoftimet për mbledhje janë respektuar afatet ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e punës së Kuvendit;

Ka funksionuar sistemi i teleprezencës me qëllim të monitorimit të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Gjithashtu mbledhjet janë monitoruar edhe përmes pranisë fizike të monitoruesve;

Të gjitha mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun;

Gjatë mbledhjeve në tërësi është respektuar Rregullorja e Punës së Kuvendit dhe është bërë përkthimi i vendimeve në gjuhët zyrtare;

Janë mbajtur takime publike me qytetarë, - diskutimet buxhetore, etj.;

Është miratuar Buxheti i Komunës;

Kryetari i Komunës ka raportuar para Kuvendit të Komunës sipas nenit 58, pika (j);

Aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës janë publikuar në faqet zyrtare elektronike në gjuhët zyrtare;

Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen gjetja e mënyrave dhe formave për të komunikuar me publikun për çështje si diskutimi për buxhetin e komunës, këmbimit dhe dhënies në shfrytëzim të pronave, miratimi i rregulloreve etj., me qëllim pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje të qytetarit. Del si detyrë që çdo anëtar i Kuvendit të Komunës për aktet normative të cilat do të diskutohen dhe vendosen në kuvend, të marrë opinionet dhe vërejtjet e publike në lagjen ose fshatin që ata përfaqësojnë para se të gjykohet apo shqyrtohet për të.

Punë të mbarë për vitin 2026 dhe faleminderit për kontributin e secilit prej jush!

Falënderimet gjithashtu shkojnë për:

- 1. Administratën e Komunës për punën e palodhur dhe mbështetjen që i kanë dhënë Sekretarisë së Kuvendit.*
- 2. Kabinetin e Kryetarit, Drejtoritë e komunës, zyrën e IT, Zyrën për informim dhe Zyrën për Shërbime me Qytetarë.*